




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Dep. 01-1893/15
 Nr. I faq. 02
 Broj stranica 02
 Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-1893/15
 Br. Prot. 01-1893/15
 Prot No 01-1893/15
 Data 09-07-2015
 Datum 09-07-2015
 Date 09-07-2015

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08/07/2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Bexhet ASLLANAJ Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë
CC:	z. Shaban HALIMI U.D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Furnizim me grurë për nevojat e MTI-së"



I nderuar z. Asllanaj,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: "Furnizim me grurë për nevojat e MTI-së" me numër të prokurimit: MTI204 15 022 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: " Furnizim me grurë për nevojat e MTI-së" me numër të prokurimit: MTI204 15 022 111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/42 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, bazuar në nevojën për **Furnizim me grurë për nevojat e MTI-së**, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 20/05/2015.

Agjencia Kundër Korrupsion **është ftuar** nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që në cilësinë e monitoruesit të marrë pjesë në vlerësimin e ofertave për tenderin: "**Furnizim me grurë për nevojat e MTI-së**" me numër të prokurimit: MTI204 15 022 111.

Më datë 30/06/2015, Agjencia ka qenë prezent në vlerësimin e ofertave së bashku me komisionin vlerësues. Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se procesi i vlerësimit është bërë në baze të parimeve kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP. Në aktivitetin e prokurimit furnizim me grurë për nevojat e MTI-së kanë ofertuar gjashtë Operator Ekonomik dhe pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të paraqitur Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar që të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës ishin të përgjegjshëm.

Agjencia konstaton se Autoriteti Kontraktues duhet të vazhdojë tutje me aktivitetin në fjalë në pajtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Autoriteti Kontraktues e informon Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !